

**S T A T U T**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**« JEMAN CONSTRUCTION» Sh.p.k.**

Ne baze te ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008. “ Per Shoqerite Tregetare” dhe te akteve te tjera ligjore;

Ne baze te Ligjit 9723, date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te Regjistrimit

Ne Tirane, sot me daten 10.03.2022 ( dymije e njezet e dy ) shtetasi: **Z. Admir Dervishi**, i biri i Sefer, lindur me 01.09.1989 ne Fushe-Kruje, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes Shqiptare me numer BD0489298.

Vendos sa vijon:

**NENI 1**

Deklaron se me vullnet te lire ,te plote , te sinqerte dhe insiativen e lire private ,mbeshtetur ne Kushtetun e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi te cituar me siper hartoj sot statutin e shoqerise «**JEMAN CONSTRUCTION» Sh.p.k**

**KREU I**

**THEMELIMI ,EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA DHE ADRESA**

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar «**JEMAN CONSTRUCTION» Sh.p.k**, Tirane, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuara ne ligj.

**Neni 2**

**Selia e Shoqerise**

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne adresen e meposhtme, **Rruga “ Tish Dahia”, Kompleksi Niku Construction, Kati i III , Tirane.**

Me vendim te Asamblese se Ortakve , selia e shoqerise mund te transferohet ne nje rajon tjetër brenda territorit te republikes se Shqiperise , gjithashtu shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise apo edhe jashte tij .

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike**

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte me nje afat te pa percaktuar.

### **Neni 4**

#### **Objekti i veprimtarise se shoqerise**

Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit qe do te jete :

- Kryerja e punimeve te ndryshme, hidrocentrale, ndertime civile dhe ushtarake sipas legjislacionit ne fuqi .
- Prodhim, perpunim dhe eksportimi i llojeve te ndryshme te materialve te ndertimit .
- Importimi , perpunimi dhe tregtimi i materialeve te ndryshme dhe mineraleve te te gjitha llojeve .
- Prodhimin dhe traqetimin e produkteve, me baze industriale, per te gjithë sektoret e ekonomise
- Prodhimin dhe traqetimin e produkteve, me baze materiale te ndryshme, per te gjithë sektore e ekonomise.
- Ndertime Industrial-Civile-Turistike dhe siper marrje per ndertime te konstruksioneve dhe veprave publike te te gjitha kategorive.
- Marrja pjese ne tendera dhe ankande si dhe kryerja e sherbimeve qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj.
- Blerje pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme, ti marre ose ti leshoje me qira, te marre tendera.
- Tregtim i materialeve te ndryshme me shumice dhe pakice ne format e parashikuara dhe te lejuara nga legjislacioni shqiptar.
- Tregtim i mallrave te ndryshem me shumice dhe pakice, industriale, te ndertimit, ushqimore e te tjera, eksportin dhe importin e tyre ne perputhje me ligjin dhe me formen e shoqerise, tregtim te prodhimeve te ndryshme ushqimore ose jo , me shumice dhe pakice eksportin dhe importin e tyre.
- Shoqeria mund te kryeje ne permbushje te qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, dhe ti hipotekojë keto ne emrin e saj.
- Tregtim, importim dhe eksportim te lendeve ambalazhuese dhe prodhimeve te tyre si dhe industrine e tyre me shumice dhe pakice.
- Kontraktim, marrja apo dhenie ne lidhje me fushen e veprimtarise se saj te cdo lloj kreditimi me afat te shkurter te mesem apo te gjate ne tregjet e brendshme apo te jashtme, te mundesoje kredi mallrash, pengjesh, importimi dhe eksportimi.
- Te perfitoje, transferoje, te marre me qira, te bleje dhe te shese, si dhe te kontraktoje te drejten e markes , patentes, licenses dhe te drejta te tjera qe jane te ngjashme me keto
- Tregtim me shumice e pakice, prodhimin, import dhe eksport i te gjitha llojeve te mallrave te lejuara nga Ligji, brenda dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise si dhe te te treteve.

## **Neni 5**

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit , te shtoje ortake, te rrise ose te zvogeloje kapitalin e saj sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerise

## **KREU II**

### **KAPITALI I REGJISTRUAR**

## **Neni 6**

### **Kapitali i Shoqerise**

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, formuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem i shoqerise, i barabarte me 1 Kuota, me vlere nominale 1 kuote / 100.000 leke, i depozituar sipas ligjit dhe perkatesisht i ndare ne Pjese te Kapitalit si me poshte:

**Z. Admir Dervishi**, i biri i Sefer, lindur me 01.09.1989 ne Fushe-Kruje, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes Shqiptare me numer BD0489298, zoteron 100 % (Njeqid perqind) te kuotave te kapitalit themeltar.

Ortaku i vetem ka te drejta pronesia mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

## **Neni 7**

### **Zmadhimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te rritet ne te ardhmen, nepermjet nenshkrimit dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortake te rinj, vetem me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve , ku do te miratohet si rritja kapitalit ashtu dhe hyrja e ortakeve te rinj.Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimeve te gjithe ortakeve

## **Neni 8**

### **Zvogelimi i Kapitalit**

Zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise do te realizohet duke u bazuar ne dispozitat e vencata qe parashikohen nga Ligji 9901 date 14.04.2008 “ Per Shoqerite tregtare “

## **KREU III**

### **Drejtimi i shoqerise**

#### **Neni 9**

Shoqeria « JEMAN CONSTRUCTION» Sh.p.k. eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

#### **Neni 10**

Ortaku i shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tij nuk mund ta terheqe, kjo behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar .

#### **Neni 11**

##### **Kuota**

Kuota e ortakut perputhet me kapitalin e shoqerise .Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise.Ortaku qe deshiron te trasnferoje ose te shese kuotat e tij I drejton nje kerkese me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar cmimin e shitjes , I cili duhet te jete I arsyeshem dhe I njejte me ate qe do ti ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e bleresit . Organi Administrativ jep pergjigje Brenda 30 diteve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetoje ortakeve te tjere kete kerkese dhe ortaket e tjere duhet te japin nje pergjigje brenda 3 muajve .Edhe e drejta e perparesite per trasnferim ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar organit Administrativ.

E drejta e perparesite per transferim ose shitjen e kuotave eshte ne proporcion me kuotat qe zoteron secili prej ortakeve ne kete shoqeri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afatin prej 3 muajsh , Brenda 30 diteve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjithë ose pjeserisht kuotat e tij.Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqerise , atehere keto kuota brenda 90 diteve i ofrohen personave te trete jashte shoqerise .Transferimi dhe shitja e kuotave te behen me akte noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Te gjitha transferimt e kuotave kane efekt mbi shoqerine qe nga momenti I regjistrimit ne librin e ortakeve dhe ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Kuotat prej 1000 leke jane te pandashme . Ne rastet e bashkepronesise veprohet sipas ligjit .

#### **Neni 12**

Emertimi i shoqerise tregtare , kapitali themeltar , emerat e administratoreve, si dhe emri e ortakut te vetem duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen e saj perreth .

## **Neni 13**

### **Organet e shoqerise**

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktuale . Ortaku i shoqerise drejton procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim .

Organet e shoqerise jane :

- Asambleja e Ortakut te Vetem
- Administratori

## **Neni 14**

### **Asambleja e Ortakeve**

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakut te vetem , e cila mblidhet sipas ceshjeve qe do te trajtohen.

Ne qofte se Asambleja eshte mbeldhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim edhe duke kerkuar ndihmen e nje personi te trete i cili eshte specialist per problemin qe eshte ne diskutim dhe do te vendoset duke marre ne konsiderat e dhe mendimin e specialistit.

## **Neni 15**

### **Te drejtat e Asamblese**

Asambleja e ortakeve ka kompetencat e meposhtme :

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut ne rast kur jane dakord ortaket qe perfaqesojne tre te katertat e kapitalit themeltar .
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit .
- Ajo emeron admonistratoret , zevendesin, ekspertet dhe revizoret kontabel.
- Ajo ka te drejte te beje perjashtimin e nje ortaku nga shoqeria per rastet e parashikuara ne ligj si dhe ne rregulloren e brendshme te shoqerise
- ajo aprovon cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese .
- Percakton shperblimin per administratoret ,ekspertet revizoret kontabel.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet .
- Ben lidhjen e kontrateve per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregetin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise so dhe kontrata ne lidhje me organet shtetetore per pjesemarrjen ne tender , ankand ose aktivitete te tjera te rendesishme .
- realizon blerje ,shitje ,si dhe tjetersim te pasurive te paluajtshme te shoqerise etj.
- Ka te drejte te beje modifikimin e kontrates se shoqerise .

## **Neni 16**

### **Mbledhjet e asamblese**

Asambleja mblidhet te pakten nje here ne vit ,brenda 4 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise vjetore .Ne kushte te vecanta Asambleja e zakonshme mund te mblidhet dhe brenda 6 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise se shoqerise .

Asambleja mund te thirret me vendimin e saj kur Organi Administrativ e sheh te arsyeshme.Ne kete rast Organi Administrativ ka te drejte te vendose ditën e mbledhjes jo me larg se 30 dite nga dita e kerkeses .

## **Neni 17**

Kur pjesemarrja ne asamble eshte normale vendimet qe merren brenda kufijve te kontrates se themelimit , Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjithë , edhe per ata qe nuk kane diskutuar edhe per ata qe nuk jane dakort .

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim pa te drejte vote eksperte , revizore etj.

## **Neni 18**

### **Vendimet e Asamblese**

Asambleja e Pergjitheshme e ortakeve te shoqerise ka kompetencat qe parashikohen edhe ne ligjin Nr. 9901 dt 14.04.2008. “ Per Shoqerite Tregetare” :

- Te marre vendime te vlefshme nepermjet votimit pro dhe me vota te vlefshme te shumices. Ne rast te ndryshimeve te nevojshme te statutit, vendimi merret me  $\frac{3}{4}$  e ortakeve.
- Te miratojne programin e shoqerise, te hartojne raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6 mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.
- Vendosin per shperberjen e shoqerise.
- Vendosin per fitimet dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullojne mardheniet e punesimit dhe shperblimit brenda shoqerise.
- Sipas akteve ligjore shlyejne detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike, vendas apo te huaj.
- Si edhe kompetenca te tjera te lejuara nga ligji.

## **Neni 19**

Marrja e vendimeve te Asamblese , mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim .

## KRE IV

### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

#### Neni 20

-Per administrimin e te ardhurave te shoqerise gjat aktivitetit te saj do te caktohen specialiste kontabel per kryerjen e te gjitha veprimeve financiare, per evidentimin e te ardhurave te realizuara, fitimit si dhe detyrimeve. Ato do te evidentohen ne librat e llogarise. Ekspertet kontabel emerohen me vendim te asamblese se ortakeve.

-Asambleja e pergjithshme emeron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

- Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

- Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

-ADMINISTRATORI:

**Dervishi Admir**

#### NENI 21

#### Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **Neni 22**

Aktiviteti i shoqërisë mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti. Bilanci duhet të shoqërohet nga një relacion i asamblese së ortakëve që sqaron mbarevajtjen e administrimit në sektore të ndryshme të aktivitetit të shoqërisë duke i kushtuar një vëmendje të madhe investimeve, çmimeve dhe kostëve si dhe fakte të tjera të rëndësishme të verejtura pas mbylljes së aktivitetit të periudhës.

## **NENI 23**

Bilanci dhe relacioni i asamblese së ortakëve duhet të depozitohet pranë selisë së shoqërisë 15 dite para mbledhjes së ortakëve që do të thirren për ta aprovuar.



#### **NENI 24**

Rastet e shperndarjes se shoqerise jane:

- Perfundimi i afatit te parashikuar per vazhdimin e saj.
- Arritja e objektivit te shoqerise ose pamundesia e arritjes se tij si dhe raste te tjera te parashikuara ne ligj.

#### **NENI 25**

Ne rast te shperndarjes se parakohshme te shoqerise, asambleja e ortakeve nga dita qe vendoset shperberja merr funksionin dhe pergjegjesine e likuidatorit me perjashtim te rasteve kur asambleja e ortakeve vendos ndryshe.

#### **NENI 26**

Ne rast se vendoset per likujdatore merret vendim nga asambleja e ortakeve me votim unanim.

#### **NENI 27**

Likujdatori brenda 6 muaj nga emerimi therret asamblene e ortakeve te cilit i paraqet raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise para fillimit te operacionit te likujdimit.

#### **NENI 28**

Likujdatori perfaqeson shoqerine dhe gezon te gjitha kompetencat e domosdoshme per likujdimin e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise. Ai eshte i autorizuar te rimbursoje te gjitha kreditoret dhe tu shperndaje ortakeve mbetjet ne dispozicion.

#### **NENI 29**

Likujdatori ploteson raportin e kontabiliteti vjetor 3 muaj mbas mbylljes se vitit financiar ne baze te inventarit mbi elemente te ndryshem te aktivitetit dhe pasivitetit si dhe nje raport te shkruar mbi administrimin dhe gjithe operacionin e likujdimit.

#### **NENI 30**

Shperndarja e aktivitetit qe mbetet pasi Pjeset e kapitalit baze do tu rikthehen ortakeve ose ortakut te vetem do tu shperndahen ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar.

### **NENI 31**

Te gjitha mosmarveshjet qe lindin midis shoqerise e te treteve apo midis ortakeve te saj n.q.s nuk zgjidhen me mirekuptim, ose ne rruge administrative, palet kane te drejte ti drejtohen per zgjidhje organeve gjyqesore.

### **NENI 32**

Per çfare nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

### **NENI 33**

Stauti hartohet ne 4 kopje origjinale.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE  
"JEMAN CONSTRUCTION"sh.p.k.**

**Z. Admir DERVISHI**

Admir

DERVISHI

